

ARSYETIM

Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2008 është përpiluar në pajtim me nenin 14 të Ligjit për buxhete (Gazeta zyrtare e RM 64/05) dhe në pajtim me Cirkularin buxhetor – Kahje për përgatitjen e buxheteve të njëjësive të vetëqeverisjeve lokale për vitin 2008 nga Ministria për financa (numër 07-35774/1 e datës 25.09.2007), me të cilin janë fituar informata për indikatorët themelor makroekonomik, kahjet kryesore për përgatitjen e buxhetit dhe lartësitë e dotacioneve të destinuara që do të transferohen në vitin 2008 nga Buxheti i RM dhe nga buxhetet e fondeve, në buxhetin e Qytetit të Shkupit.


Propozim Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2008 i përmban të gjitha të hyrat dhe të ardhurat tjera të cilat vlerësohet t'i realizojë Qyteti i Shkupit në vitin 2008, në vlerë gjithsej prej 2.924,3 milion denarë të cilat të paraqitura sipas kategorive janë si vijon:

BUXHETI I PËRGJITHSHËM		vlera	pjesëmarrje (%)
Të hyrat tatimore		1.575.800.000	53,89
Të hyrat jotatimore		481.073.963	16,45
Të hyrat kapitale		120.950.000	4,14
Dotacione të destinuara		211.825.077	7,24
Transfere		220.070.000	7,53
Donacione		74.548.460	2,55
Shitje e letrave me vlerë		240.000.000	8,21
Gjithsej:		2.924.267.500	100,00

Në pajtim me klasifikimin shpenzues buxheti i përgjithshëm i Qytetit të Shkupit për vitin 2008, planifikohet të shpenzohet për këto kategori të shpenzimeve:

BUXHETI I PËRGJITHSHËM		vlera	pjesëmarrje (%)
40	Paga, qira dhe kompenzime për të punësuarit	294.053.963,00	10,06
41	Rezerva dhe harxhime të padefinuara	15.000.000,00	0,51
42	Mallra dhe shërbime	1.081.684.726,00	36,99
46	Subvencione dhe transfere	271.367.283,00	9,28
48	Shpenzime kapitale	1.262.161.528,00	43,16
Gjithsej:		2.924.267.500,00	100,00

Në pajtim me **klasifikimin e inkorporuar funksional** të cilin e shpall Njësia statistikore e Kombeve të Bashkuara, dhe e cila paraqet pasqyrë të hshpenzimeve të Qytetit të Shkupit sipas qëllimeve të tyre, shpenzimet buxhetore sipas funksioneve të Qytetit të Shkupit janë si vijon:



Buxheti i Qytetit të Shkupit si plan vjetor i të ardhurave, derdhje të tjera dhe mjete të miratuara përfshin buxhetin themelor, buxhetin e dotacioneve destinuese, buxhetin e aktiviteteve vetëfinancuese dhe buxhetin e donacioneve.

Vlerat dhe pjesëmarrja e secilit nga këto buxhete në Buxhet është si më poshtë vijon:

BUXHETI I PËRGJITHSHËM I QYTETIT TË SHKUPIT	2.924.267.500	100.00%
Buxheti themelor	2.200.000.000	75,23%
Buxheti i dotacioneve destinuese	211.825.077	7,24%
Buxheti i aktiviteteve vetëfinancuese	437.893.963	14,97%
Buxheti i donacioneve	74.548.460	2,55%

Në **buxhetin themelor** janë projektuar të ardhurat dhe mjetet e miratuara sipas destinimeve për financimin e kompetencave të Qytetit të Shkupit

Në buxhetin themelor të Qytetit të Shkupit janë projektuar të gjitha llojet e të ardhurave dhe të derdhjeve të tjera, që në përputhje me dispozitatat themelore mund të realizohen dhe atë:

TË ARDHURA TË PËRGJITHSHME	2.200.000.000	100,00
Të ardhura tatimore	1.575.800.000	53,89
Tatime jotatimore	73.800.000	2,52
Të ardhura kapitale	120.950.000	4,14
Transfere	189.450.000	6,48
Shitja e letrave me vlerë	240.000.000	8,21

Të ardhurat tatimore të projektuara me pjesëmarrje 53.9% planifikohen të realizohen nga tatimi mbi pronën, nga tatimi personal i të ardhurave nga taksat komunale. Të ardhurat jotatimore do të realizohen nga taksat dhe kompensimet, taksa administrative dhe të ardhura të tjera jotatimore (2.5%). Të ardhurat kapitale pritet të realizohen nga dhënia nën koncension e vendeve

për reklamim dhe shpallje. Transfere planifikohen të realizohen nga TVSH, nga Fondi i rrugëve dhe priten transfere kapitale nga Buxheti i RM. Kategoria e fundit e të ardhurave janë të ardhurat e planifikuara nga shitja e pjesëve të Qytetit të Shkupit në sallën e sportit.

Në përputhje me klasifikimin e shpenzimeve buxheti themelor i Qytetit të Shkupit për vitin 2008, planifikohet të harxhohet për këto kategori shpenzimesh:

	SHPENZIME TË PËRGJITHSHME	2.200.000.000	100,00
40	Paga, qera dhe kompensime për të punësuarit	176.234.000	8,01%
41	Rezerva dhe shpenzime të padefinuara	15.000.000	0,68%
42	Mallra dhe shërbime	615.501.332	27,98%
46	Subvencione dhe transfere	219.266.000	9,97%
48	Shpenzime kapitale	1.173.998.668	53,36%


Kategoria **40-Paga, qera dhe kompensime për të punësuarit**, në buxhetin themelor merr pjesë me **8,01%** dhe këto mjete planifikohen për pagimin e pagave themelore dhe kontributeve për të punësuarit në administratën e qytetit dhe për pagimin e kompensimeve mujore për pjesëmarrje në seancë të këshilltarëve të Qytetit të Shkupit, si dhe paga për 40 zjarrfikës që planifikohen të punësohen në vitin 2008 financimi i të cilëve nuk do të realizohet nga dotacioni destinues për shkak të mosdhënies pëlqim nga Ministria për financa e RM.

Kategoria **41-Rezerva dhe shpenzime të padefinuara (0.68%)**, përfshin mjete ta planifikuara për rezervën rrjedhëse dhe permanente të Qytetit të Shkupit, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara dhe të shumëllojshme që do të ketë gjatë vitit.

Në kategorinë **42-Mallra dhe shërbime** janë planifikuar të gjitha shpenzimet, që kanë të bëjnë me administratën e qytetit, duke përfshirë edhe Brigadën për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit, dhe të gjitha shpenzimet rrjedhëse-operative për realizimin e kompetencave ligjore.

Kategorijata **46-Subvencione dhe transfere**, përfshin mjete të planifikuara për subvencionimin e biletave të autobusit të Ndërmarrjes të transportit publik, transfere deri te organizatat joqeveritare për realizimin e projekteve nga fusha e kulturës, mbrojtja sociale dhe arsimit i mesëm; dhe transfere të ndryshme për financimin e projekteve nga fusha e kulturës që do t'i realizojnë institucionet publike nga fusha e kulturës nën kompetencat e Qytetit, si dhe mjete për sigurimin e pjesëmarrjes së vetë të nevojshme për projektet që janë financuar nga donacione.


Shpenzimet kapitale – kategoria 48, marrin pjesë me **53,36%** në buxhetin themelor të Qytetit të Shkupit, ku në kornizat e kësaj kategorie janë planifikuar: rikonstruksioni i nevojshëm i objektit në të cilin është e rregulluar administrata e qytetit; rikonstruksioni i magazinave për inspektimin e qytetit; ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugëve magjistrale dhe mbledhëse, ndriçimi publik, sinjalizimi rrugor, objekte të tjera nga infrastruktura komunale në kornizat e rregullimit të truallit ndërtimor, ndërtimi i sistemeve për përcjelljen dhe pastrimin e ujit, pajisje kompjuterike dhe pajisje të tjera për përveç nevojat e administratës së qytetit, pajisje për mirëmbajtjen e rrugëve dhe pajisje – softuer smart ticketing për ndjekjen e transportit publik dhe mjete për kompensim për tokë të marrë dhe pronë të marrë për realizimin e rrugëve të reja.

 Në **buxhetin e dotacioneve destiuuese** janë projektuar të ardhurat nga dotacionet dhe mjetet e miratuara që shfrytëzohen për financimin e qëllimeve konkrete, kompetencë, program dhe prijekt investues

Në buxhetin e dotacioneve janë projektuar dotacione projektuese nga buxheti i RM të cilat janë parashikuar për financimin e kompetencave bartëse.

GJITHSEJ DOTACIONE TË DESTINUARA	211.825.077	100,00%
Dotacion destinues për aktivitete nga kultura	27.753.594	13,10%
Dotacion destinues për aktivitete nga arsimi	83.931.100	39,62%
Dotacion destinues për aktivitete nga mbrojtja sociale	7.329.383	3,46%
Dotacion destinues për aktivitete në mbrojtjen kundër zjarrit	92.811.000	43,81%

Në pjesën **mjete të miratuara** në buxhetin e dotacioneve, 100% nga dotacioni i aktiviteteve në kulturë dhe për arsim të mesëm janë projektuar për shërbime komunale, ngrohje, komunikacion dhe transport, përkatësisht për mbulimin e shpenzime operative bazë për funksionimin e pandërprerë të institucioneve kulturore dhe shkollave të mesme. Dotacioni destinues në fushën e mbrojtjes sociale është transferi i mjeteve deri te Shtëpia për persona të moshuar Nënë Tereza, ndërsa dotacioni destinues në fushën e zjarrfikësve është për pagt e zjarrfikësve të Qytetit të Shkupit.

 Në **buxhetin e dotacioneve** janë projektuar të ardhurat nga donacionet dhe mjete të miratuara që shfrytëzohen vetëm në mënyrë destiuuese në përputhje me kontratat e nënshkruara me donatorët.

Në pjesën **shpenzime** në buxhetin e donacioneve janë projektuar të ardhurat nga donacione të Qytetit të Shkupit dhe të ardhura nga donacione të shfrytëzuesve të buxhetit të Qytetit të Shkupit, që pritet të realizohet vitin e ardhshëm.

Në pjesën **mjete të miratuara** në buxhetin e donacioneve 47.5% janë parashikuar shpenzime kapitale, përkatësisht për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve ndërtimore, si dhe për blerje mobiljesh, pajisjesh, automjetesh, makinerish, kafshë, përderisa pjesa e mbetur nga donacionet është parashikuar për komunikacion dhe transport, dhe për transfere.

- Në **buxhetin e aktiviteteve vetëfinancuese** janë projektuar të ardhurat dhe shenzimet e aktiviteteve të shfrytëzuesve buxhetor të cilat janë plotësuese të aktiviteteve themelore

Në anën e **të ardhurave** në buxhetet e aktiviteteve vetëfinancuese janë projektuar të ardhurat e taksave në arsim, të ardhurat nga shitja e prodhimeve, biletave, antarësive, të ardhura nga qiratë e hapësirave afarsite e tj.

Në anën e **mjeteve të lejuara** në bushetin e aktiviteteve vetëfinancuese janë projektuar shpenzime për ndërtim, rikonstrukcion, mirëmbajtje, blerje të mjeteve dhe pajisjeve si dhe transfere të ndryshme dhe shërbime të kontraktuara për organizimin e aktiviteteve arsimore dhe kulturore të kushtuara për përparimin, modernizimin dhe zhvillimin e veprimtarive në institucionet e fushës së kulturës dhe shkollave të mesme.